

FTESE PËR OFERTË

Emri dhe adresa e Autoritetit Kontraktor

Emri: Albgaz Sh.a.

Adresa: Njësia Administrative nr. 5, rruga e “Kosovarëve”, pallati “Ndër Pro” Sh.p.k., Tiranë.

Adresa e Internetit:

E-mail: drini.mataj@albgaz.al

Autoriteti Kontraktor Albgaz Sh.a. do të zhvillojë procedurën e prokurimit elektronik për blerjen e biletave të transportit ajror ndërkombëtar me objekt: **“Blerje bilete avioni vajtje-ardhje me destinacion “Tiranë– Romë dhe Romë - Tiranë”.**

Data e zhvillimit do të jetë; **24.10.2023, ora: 19:00**, në adresën www.app.gov.al.

Për sa më sipër jeni të lutur të paraqisni ofertën tuaj **të shprehur në vlerë totale në lekë** për këtë objekt prokurimi me këto të dhëna me *(specifikimet teknike të mallit/shërbimit/punës)*:

I. SPECIFIKIME TEKNIKE:

- **1 biletë Tiranë (TIA) – Romë (FCO)**, nisja nga Tirana në datën 25/10/2023 Ora: 11:30, linjë direkte, me bagazhe të përfshira, dhe mbërritja në **Romë (FCO)**, në po të njëjtën datë.
- **1 biletë Romë (FCO)- Tiranë (TIA)**, nisja nga Roma në datën 26/10/2023 Ora: 23:00, me bagazhe të përfshira, mbërritja në Tiranë po në të njëjtën datë.
- Preferohet klasi ekonomik.

II. KRITERET KUALIFIKUESE

- **Operatori ekonomik duhet të ketë në objektin e aktivitetit të tij tregtar, (Q.K.B.) shitjen e biletave të transportit ajror, mungesa e të cilit përbën shkak për refuzim të ofertës.**
- **Operatori ekonomik me anë të një vetë deklarimi me shkrim, duhet të marrë përsipër se;**
 - Do të jetë në gatishmëri për kryerjen me sukses të shërbimit të biletarisë, gjatë 24 orëve.
 - Do të angazhohet me përgjegjësi të lartë për zgjidhjen e problemeve lidhur me vonesat e fluturimeve, humbjen e bagazheve, sendeve të tjera si dhe çdo rast tjetër i paparashikueshëm.

- Për çdo rast udhëtimi, operatori ekonomik duhet të marrë masat e menjëhershme, në rastet e ndryshimit të destinacionit të fluturimit, orarit të biletës dhe të ditës së fluturimit, dhe të sigurojë vijimësinë e udhëtimit në destinacion në një kohë sa më të shpejtë nga itinerari fillestar.
 - Të garantojë përballimin e çdo pasojë të mundshme ekonomike, në raste të jashtëzakonshme, si fatkeqësi natyrore, kushte të këqija të motit, grevë apo falimentim të operatorit, në rastet e ndryshimit të destinacionit të fluturimit, orarit të biletës dhe të ditës së fluturimit, të cilat nuk vijnë si pasojë e veprimit të Autoritetit Kontraktor.
 - Të garantojë ruajtjen e konfidencialitetit, përsa i takon informacionit të siguruar nga Autoriteti Kontraktor.
 - Të garantojë përfitimet e bonuseve të ofruara nga programet e linjave/agjencive të udhëtimit për miljet nga të gjitha linjat të ofruara në rastet kur miljet përfitohen nga Autoriteti Kontraktor.
- **Shënim:** Në bazë të Njoftimit të Përbashkët të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve me nr. 25366 prot datë 30.12.2020 dhe Agjencisë së Prokurimit Publik me nr. 8480 prot datë 30.12.2020 informojmë të gjithë Operatorët Ekonomikë të interesuar që duhet të kenë dhe të paraqesin:
 - Kopje të Çertifikatës elektronike për Fiskalizimin, për tatimpaguesit që përdorin Platformën Qendrore të Faturave.
 - Kopje të Çertifikatës elektronike për Fiskalizimin dhe kopje të vlefshme të kontratës së lidhur me shoqërinë e çertifikuar për zgjidhjen e software-ike në përdorim, për tatimpaguesit që lëshojnë faturat nëpërmjet zgjidhjes software-ike.

III. TË TJERA

Në rast të marrjes përsipër të realizimit, operatori ekonomik i renditur i pari, përpara se të shpallet fitues, duhet të dorëzojë menjëherë nëpërmjet sistemit të prokurimit elektronik, dokumentet si më poshtë:

- Rezervimin e biletës sipas destinacionit të kërkuar, me itinerare të detajuara, duke përfshirë klasin, sasinë, statusin dhe të dhëna të tjera alfanumerike që kanë të bëjnë me segmentet e udhëtimit, si dhe kodin e llogarisë së klientit.
- Operatori Ekonomik duhet të ketë dhe të dëshmojë që është i pajisur me certifikatë akreditimi/marrëveshje lëshuar nga/me International Air Transport Association (**I.A.T.A.**), të vlefshme.
- Operatori Ekonomik duhet të ketë dhe të dëshmojë që disponon certifikatën e menaxhimit të cilësisë **ISO 9001:2015**, të vlefshme dhe të akredituar nga D.P.A. ose nga organizma ndërkombëtarë akreditues të njohura nga Republika e Shqipërisë.
- Operatori Ekonomik duhet të garantojë se zotëron burime të nevojshme njërëzore dhe teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standarti të përshtatshëm cilësie. Operatori ekonomik të ketë 10 vite eksperience në treg.
- Operatori Ekonomik i renditur i pari, duhet të paraqitet pranë autoritetit kontraktor **jo më vonë se 2 orë, nga momenti i marrjes së njoftimit të fituesit.**
- Vërtetimin Bankar (IBAN)
- Në ofertën e tij, ofertuesit duhet të paraqesë të dhënat e plota të personit të kontaktit.



- Mosparaqitja pranë Autoritetit Kontraktor ju skualifikon, dhe procedurat vazhdojnë me Operatorin Ekonomik i renditur i dyti e kështu me rradhë.

(Dokumentat duhet të jenë të vlefshme në kohën e dorëzimit, origjinale ose kopje të noterizuara, sipas legjislacionit shqiptar në fuqi.)

Në vijim për gjithë sa më sipër, kërkohet nga ju vlerësimin me seriozitet të kërkesave tona përpara se të ofertoni, në mënyrë që të përmbushni detyrimet që merrni përsipër me paraqitjen e ofertës, në rast se shpalleni fitues.

**TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR/OSE PERSONI I
AUTORIZUAR PREJ TIJ**